



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1517/24 Datë: 05/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Teknik Dentar BSc 180 ECTS R me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 2. *Media dhe Komunikim BA 180 ECTS R me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
 3. *Studime të Sigurisë BSc 180 ECTS R me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;*
 4. *Shkenca Politike BA 180 ECTS R me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
 5. *E Drejta Penale LLM 60 ECTS R me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Teknik Dentar BSc 180 ECTS R</i>	Burim Kiseri Nexhmije Ajeti Aida Rexhepi
2.	<i>Media dhe Komunikim BA 180 ECTS R</i>	Naser Rugova Gjylie Rexha Xhevahire Millaku Votim Hanolli
3.	<i>Studime të Sigurisë BSc 180 ECTS R</i>	Arian Kadriu Gjon Culaj Bahri Gashi
4.	<i>Shkenca Politike BA 180 ECTS R</i>	Alfred Marleku Dritero Arifi Ngadhujm Brovina Liburn Mustafa
5.	<i>E Drejta Penale LLM 60 ECTS R</i>	Ahmet Maloku

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë në përbërje: *Adrian Stan, Sabri Nibal, Majda Tafra, Jakob Patekar, Katerina Klimoska, Hans Joachim Giessmann, Marko Komso, Matthew Kitching, Dunja Duic, Johannes Falterbaum dhe Christoph Back.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Teknik Dentar BSc 180**, më 31.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Media dhe Komunikim BA 180**, më 19.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.

3. **Për programin e studimit; Studime të Sigurisë BSc 180**, më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) dhe Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Studime të Sigurisë BSc 180**, më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) kurse Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Studime të Sigurisë BSc 180**, më 28.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126 të mbajtur më datë 22.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hashija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë